

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.411/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.411/2023 të datës 24.02.2023, të parashtruar nga ankueses me adresë nr.12, Lagja Qëndresa, Veternik Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 12.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

~~I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.411/2023 e datës 24.01.2023, e parashtruar nga ankuesja~~

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.Nr.13/2023 i datës 26.01.2023, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datën 10.11.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm, për pozitën e punës "Zyrtar ligjor 2", në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. Konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 10.11.2022 deri me datën 24.11.2022, ku si pjesëmarrës në këtë konkurs ka qenë edhe ankuesja Në listën e ngushtë të datës 05.12.2022, e publikuar nga ana e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, janë përfshirë njëqind e shtatëdhjetë e dy (172) kandidatë, ndër ta edhe ankuesja e cila ka marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit lidhur me këtë pozitë. Kurse bazuar në Njoftimin për përzgjedhje përfundimtare të datës 29.12.2022 të Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, si kandidat të suksesshëm lidhur me këtë pozitë



janë shpallur kandidatët  
gjithsejtë 77.9 pikë në total,  
gjithsejtë 73.9 pikë në total.

me gjithsejtë 83 pikë në total,  
me gjithsejtë 77.6 pikë në total dhe

me  
me

Ankuesja e pa kënaqur me rezultatin përfundimtar të datës 16.12.2022 dhe 29.12.2022 , me datën 19.01.2023 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së, me pretendimet ankimore për shkelje procedurale, shkelje të rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit KA.Nr.13/2023 të datës 26.01.2023 refuzon si të pa bazuar ankesën e ankueses të datës 26.01.2023, duke lënë në fuqi Njoftimin e datës 29.12.2022 lidhur me kandidatët e e suksesshëm të lëshuar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore në SKPK.

Kundër Vendimit KA.Nr.13/2023 të datës 26.01.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së, ankuesja brenda afatit ligjor me datën 24.02.2023 parashtron ankesë me numër të protokollit 2042/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.411/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave, me datën 28.02.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 2176/2023 tek SKPK, ndërsa me datën 10.03.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritorie ka administruar këto prova:* Ankesën e ankueses me numër protokollit 2042/2023 të datës 24.02.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KA.Nr.13/2023 të datës 26.01.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.02.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 10.03.2023 nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Konkursin e datës 10.11.2022; Vendimin DPSKPK/Nr.569/2022 të datës 29.11.2022 lidhur me formimin e komisionit përzgjedhës; Vendimin DPSKPK/Nr.579/2022 të datës 30.11.2022; Deklaratën DBNJ/Nr.358/2022 të datës 29.11.2022; Deklaratën DKSPKP/Nr.568/2022 të datës 29.11.2022; Listën me regjistrin e aplikacioneve të pranuar të kandidatëve aplikues; Listën përfundimtare të përzgjedhjes së listës së ngushtë të datës 05.12.2022; Njoftimin e datës 02.12.2022 lidhur me kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë; Njoftimin e datës 05.12.2022 lidhur me listën e ngushtë plotësuese; Raportin mbi përgatitjen e listës së shkurtër të datës 05.12.2022; Listat me formularët mbi vlerësimin e kandidatëve nga komisioni përzgjedhës; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim të datës 16.12.2023; Rezultatet e testit me shkrim të datës 16.12.2022; Testin me shkrim të datës 08.12.2022 së bashku me çelësin e përgjigjeve të sakta; Deklaratat e datës 08.12.2022 për mosekzistimin e konfliktit të interesit nga kandidatët aplikues; Formularët e vlerësimit individual të intervistës me gojë të datave 20.12.2022, 21.12.2022; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të intervistës të datës 23.12.2022; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 23.12.2022; Raportin final të rekomandimit nga



komisioni rekrutues të datës 23.12.2023; Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare të datës 29.12.2022; Ankesën e ankueses të datës 19.01.2023 e parashtruar tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me numër KA.Nr.13/2023 të datës 26.01.2023 të KZKA-së; Aplikacionin për punësim të datës 22.11.2022 për kandidatin [ ] se bashku me dëshminë mbi përvojën e punës dhe atë profesionale, certifikatat mbi përfundimin e trajnimeve, certifikatën mbi evidencën penale si dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin për punësim të datës 24.11.2022 për kandidatin [ ] se bashku me dëshminë mbi përvojën e punës dhe atë profesionale, formularin për vlerësimin e performances, certifikatën mbi përfundimin e provimit të jurisprudencës, certifikatën mbi evidencën penale si dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin për punësim të datës 24.11.2022 për kandidatin [ ] se bashku me dëshminë mbi përvojën e punës dhe atë profesionale, certifikatat mbi përfundimin e trajnimeve, certifikatën mbi evidencën penale si dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin për punësim të datës 23.11.2022 për kandidatin [ ] se bashku me dëshminë mbi përvojën e punës dhe atë profesionale, certifikatat mbi përfundimin e trajnimeve si dhe certifikatën mbi evidencën penale; Aplikacionin për punësim të datës 18.11.2022 për ankuesen [ ] së bashku me dëshminë mbi përvojën e punës dhe atë profesionale, certifikatën mbi përfundimin e trajnimit, certifikatën mbi evidencën penale si dhe kopjen e letërnjoftimit.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresat të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses [ ] është e pa bazuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se komisioni përzgjedhës në testimin me shkrim dhe në intervistën me gojë nuk e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë, si dhe e njëjta thekson se ky komision nuk i ka bërë vlerësimin real të përvojës së punës në krahasim me kandidatet e përzgjedhur, sepse kandidatët e pranuar nuk i plotësojnë kushtet e konkursit dhe me këtë rast kërkon që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të bëhet rivlerësimi tek rezultati përfundimtar.

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i shkresave të lëndës e ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses, ka gjetur se për pozitën e punës *Zyrtar ligjor 2, për katër (4) pozita në Prokurorinë Themelore në Prishtinë*, si kritere themelore të përcaktuar kanë qenë: Përgatitja profesionale dhe kualifikimi: *Diplomë universitare, Fakulteti Juridik, Përvoja e punës: Një (1) vit përvojë pune profesionale*. Rrjedhimisht, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës është konstatuar se kandidatët e përzgjedhur kanë plotësuar kriteret e konkursit, ngase Kolegji i Këshillit ka gjetur se fillimisht kandidatja e përzgjedhur [ ] me rastin e aplikimit ka dorëzuar gjegjësisht posedon Diplomën me numër 6503 të datës 24.09.2019 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me të cilën dëshmohet se e njëjta me datën 02.07.2019 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik dhe me këtë rast ka marrë titullin Jurist i diplomuar-Bachelor, po ashtu e njëjta posedon Diplomën me numër 2725 të datës 27.01.2022 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me të cilën dëshmohet se e njëjta me datën 19.01.2022 ka përfunduar studimet master në Fakultetin Juridik dhe me këtë rast ka marrë titullin LL.M. (Master) në të drejtën penale, si dhe me përvojë të punës sipas Vërtetimit Vr.Nr.353/2022 të datës 29.03.2022 të lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës me të cilin dëshmohet se nga data 30.03.2021 deri më 29.03.2022 ka vijuar stazhin e praktikantes në zyrën e avokatit [ ] me seli në Prishtinë, Vërtetimit me Nr.328/2021 të datës 04.06.2021 të lëshuar nga Gjykata Themelore



në Prishtinë me të cilën dëshmohet se e njëjta ka qenë e sistemuar ne administratën e GJ.TH.M me projektin "Youth Initiative for Human Rights" nga data 01.06.2020 deri me 30.11.2021 si staf mbështetës i gjykatës nga organizata YIHR si dhe Vërtetimit Nr.468/2017 të datës 17.10.2017 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri me të cilën dëshmohet se e njëjta ka mbajtur praktikën në gjyqësorin dhe administratën e kësaj gjykate nga data 05.06.2017 deri me 04.09.2017. Kandidati \_\_\_\_\_ me rastin e aplikimit ka dorëzuar gjegjësisht posedon Diplomën me numër 7020 të datës 21.09.2020 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me të cilën dëshmohet se i njëjti me datën 03.08.2020 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik dhe me këtë rast ka marrë titullin Jurist i diplomuar-Bachelor si dhe me përvojë te punës sipas Certifikatës SKPK/DBNJ/Nr.01 të datës 17.11.2021 të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës me të cilën dëshmohet se i njëjti ka kryer stazhin e praktikës ne baze vullnetare pa pagese nga data 18.11.2020 gjer me datën 17.11.2021 në institucionin Prokuroria e Apelit të Kosovës. Kandidati \_\_\_\_\_ me rastin e aplikimit ka dorëzuar gjegjësisht posedon Diplomën me numër 5690 të datës 13.09.2018 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me të cilën dëshmohet se i njëjti me datën 28.06.2018 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik dhe me këtë rast ka marrë titullin Jurist i diplomuar-Bachelor, si dhe me përvojë tw punës sipas Vërtetimit Vr.Nr.213/2021 të datës 27.01.2021 të lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës me të cilin dëshmohet se i njëjti ka vijuar stazhin e praktikantit në zyrën e avokatit \_\_\_\_\_ në Prishtinë, prej periudhës kohore 28.01.2020 deri më 27.01.2021, ndërsa kandidati \_\_\_\_\_ me rastin e aplikimit ka dorëzuar gjegjësisht posedon Diplomën me numër 5095 të datës 28.03.2018 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me të cilën dëshmohet se i njëjti me datën 04.09.2017 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik dhe me këtë rast ka marrë titullin Jurist i diplomuar-Bachelor si dhe me përvojë tw punës sipas Vërtetimit DBNJ/Nr.240/2022 te datës 14.07.2022 te lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës me të cilën dëshmohet se i njëjti nga data 01.12.2021 deri me 14.07.2022 ka punuar si praktikant pa pagesë në kohëzgjatje prej 7 muaj e 13 ditë si dhe kontratën e punës nga SHPRK-Social Housing and Property Rights in Kosovo me të cilën dëshmohet se i njëjti ka punuar nga data 01.03.2020 deri më 30.11.2020. Kurse kandidatja-ankuesja \_\_\_\_\_ me rastin e aplikimit ka dorëzuar gjegjësisht posedon Diplomën me numër 483/1209 të datës 04.12.2009 të lëshuar nga Kolegji Universitar "Fama" me të cilën dëshmohet se e njëjta me datën 30.01.2009 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik dega e përgjithshme dhe me ketë rast ka marre titullin Baçelor i Drejtësisë si dhe e njëjta posedon Diplomën me numër 1011-3857/1 të datës 12.12.2022 të lëshuar nga Universiteti i Evropës Juglindore-Tetovë në Fakultetin e Drejtësisë, me të cilën dëshmohet se e njëjta i ka përfunduar provimet e parapara te studimeve pasdiplomike në programin studimor E drejta penale dhe me këtë rast ka fituar titullin shkencor Magjistër i shkencave juridike, ndërsa lidhur me përvojën e punës e njëjta ka bashkangjitur Marrëveshjen për angazhim në masën aktive të tregut të punës me numër 132 të datës 04.03.2017 te lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me të cilën dëshmohet se e njëjta ka qenë e angazhuar si praktikante nga periudha 01.03.2019 deri më 31.08.2019 si dhe nga data 05.09.2019 deri më 05.03.2020 si dhe posedon Certifikatën me numër SKPK/DBNJ/Nr.13 të datës 16.04.2019 të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës me të cilën dëshmohet se e njëjta ka kryer stazhin e praktikës në bazë vullnetare pa pagesë nga data 26.03.2018 deri më 25.03.2019 ne Prokurorinë Themelore në Prishtinë.



Kështu që duke ju referuar provave të administruara si me lartë, Kolegji i Këshilli konstaton kandidatët e përzgjedhur i kanë plotësuar kriteret e konkursit në kuptim të kualifikimit dhe përvojës së kërkuar të punës, dhe si rrjedhojë Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin përfshirjes së tyre në listën e shkurtër ka vepruar në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 ku përcaktohet se: "1. Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: 1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional; si dhe 1.2. përvoja e punës", andaj edhe pretendimi ankimor i ankueses në lidhje me atë se kandidatë e përzgjedhur nuk i plotësojnë kushtet e konkursit është i pa bazuar dhe jo ligjor.

Kolegji i Këshillit bazuar në provat e lëndës, respektivisht formularin e datës 23.12.2022, lidhur me përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës me gojë ka gjetur se kandidatët e përzgjedhur si në vijim: kandidatja \_\_\_\_\_ në testin me shkrim dhe intervistën me gojë ka grumbulluar gjithsejtë 83.9 pikë, kandidati \_\_\_\_\_ në testin me shkrim dhe intervistën me gojë ka grumbulluar gjithsejtë 77.9, kandidati \_\_\_\_\_ në testin me shkrim dhe intervistën me gojë ka grumbulluar gjithsejtë 77.6 pikë, kandidati \_\_\_\_\_ në testin me shkrim dhe intervistën me gojë ka grumbulluar gjithsejtë 73.9 pikë ndërsa ankuesja nga testimi me shkrim dhe intervista me gojë ka grumbulluar gjithsejtë 72.2 pikë dhe është renditur e gjashta (6) në këtë listë, ndërsa kandidatët e përzgjedhur kanë arritur më së shumti pikë duke u renditur me numër rendor 1 , 2, 3 dhe 4 në listën e kandidateve të suksesshëm. Rrjedhimisht, nga shqyrtimi i çelësit të testit me shkrim është konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, ka vepruar në pajtim me nenin 37, 38 dhe 39 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe nuk është vërejtur ndonjë shkelje procedurale ngase të gjithë kandidatëve i është dhënë mundësia e barabartë për t'iu nënshtruar të gjitha procedurave të rekrutimit, kështu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, konkretisht edhe me nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku parashihet se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë*".

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se testi me shkrim nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë konkretisht pjesa e parë lidhur me esetë e parashtruara nga Komisioni Përzgjedhës, duke ju referuar kështu pjesës së parë të testit me shkrim, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se testi me shkrim për pozitën *Zyrtar ligjor* 2 të mbajtur me datë 08.10.2022 ka qenë i përpiluar në pajtueshmëri me nenin 36 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, pasi që pjesa e parë e testit me shkrim që ka të bëjë me njohuritë e përgjithshme është përberë nga tre (3) ese, pjesa e dytë e testit me shkrim që ka të bëjë me aftësitë e përgjithshme dhe të personalitetit, është përbërë nga dymbëdhjetë (12) pyetje me përgjigje të shumëfishta, si dhe pjesa e tretë e testit me shkrim që ka të bëjë me njohuritë e vendit të punës është përberë nga gjashtëmbëdhjetë (16) pyetje, prej tyre gjysma me përgjigje të shumëfishta dhe gjysma në formë eseje të shkurtra, gjatë analizimit të testit me shkrim të ankueses dhe të kandidatëve të përzgjedhur nuk është vërejtur ndonjë parregullsi e cila mund ta ketë favorizuar respektivisht dëmtuar ndonjërin nga kandidatët në procedurë rekrutimi, kështu që në rrethanat e rastit konkret Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores



Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, nenin 36 paragrafit 2, ku përcaktohet se: *Kandidatët të cilët kalojnë me sukses testin me shkrim ose arrijnë të mbledhin 50% të pikëve të përcaktuara nga KPSHC pranohen të hyjnë në testimin me gojë, ndërsa në bazë të përmbledhjes së vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës me gojë kandidatët e përzgjedhur kanë grumbulluar më së shumti pikë, kështu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Komisioni Përzgjedhës me rastin e rekomandimit të kandidatëve të suksesshëm për emërim në shërbimin civil, ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 40 paragrafin 1 ku përcaktohet se: "Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testin me shkrim dhe me gojë".* Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankueses në drejtim të asaj se e njëjta nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë lidhur me pjesën e parë tek esetë e parashtruara nuk qëndron, ngase duke ju referuar përgjigjeve të sakta të pyetjeve nga testimi me shkrim, të siguruara nga organi përkatës i punësimit, rrjedh se e njëjta nuk ka arritur të jap përgjigje të sakta në të gjitha pyetjet e testit të parapara si në çelësin e testit me shkrim duke qenë përgjigje të plota, kështu që Kolegji konstaton se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e vlerësimit të testimit me shkrim të ankueses, ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 37 dhe 39 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil si dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës gjë që pretendimi ankimor i saj në këtë drejtim është i pabazuar dhe jo ligjor.

Andaj, bazuar si më sipër Kolegji vlerëson se procedura e rekrutimit për pozitën "Zyrtar ligjor 2" në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës"* dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, sepse ankuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë në këtë proces, siç pretendon i njëjti, rrjedhimisht Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës me rastin e zhvillimit të kësaj procedure ka vepruar në pajtim me dispozitat e lartcekura ligjore. Ndërsa, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.Nr.13/2023 të datës 26.01.2023, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar ligjin material duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.


Kështu që duke u mbështetur në nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente,/Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.411/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

  
Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.